REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr6055Prot Maliq, më 15.10.2026

VENDIM

Nr. 122, datë 14.10.2026

PËR
"Disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 2, datë 08.01.2026 "Rishqyrtim i Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 147, datë 24.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës të Bashkisë dhe strukturave të tjera të varësisë", i ndryshuar"

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", neni 29/1, shkronja "a", neni 54, shkronja "ç", ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 31.05.2023 *"Për klasifikimin e e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendor, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 2, datë 08.01.2026 "*Rishqyrtim i Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 147, datë 24.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës të Bashkisë dhe strukturave të tjera të varësisë",* këshilli i bashkisë,

VENDOSI:

I. Të miratoj disa ndryshime në strukturën organizative të Bashkisë Maliq si më poshtë:

1- Në strukturën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, në lidhja nr. 5 të bëhen disa ndryshime si më poshtë:

- Në "*Sektorin e Mirëmbajtje Objekte Publike*", pozicioni i punës *"**Mbulues çatie riparues***", me nr. rendor 16 në këtë drejtori, të ndryshohet dhe të bëhet: "***Usta, Riparues***", Klasa "Pika 11", paga për pozicion bëhet në masën **57.000** (*pesëdhjetë e shtatë mijë*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë, me 8 orë pune;

- Në "*Sektorin e mjeteve te renda*", pozicioni i punës *"**Shofer shërbimet***", të ndryshohet dhe të bëhet: ***"Shofer Autoboti"***, Klasa "Pika 9/10", paga për pozicionet bëhet në masën **60.000** (*gjashtëdhjetë mijë*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë;

II. Efektet financiare fillojnë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe përballohen nga buxheti i miratuar i Bashkisë Maliq për vitin 2026.

III. Për nxjerrjen e urdhrit dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas percaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar.

Miratuar me 18 vota
Vota Pro 18
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 15.10.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

